



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË POGRADEC

KËRKESË

PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS PREVENTIVE MBI PASURITË

GJYKATES SE SHKALLËS SË PARË
POGRADEC

Kërkues : Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec, përfaqësuar nga Prokurori S ■■■ K ■■■.

Objekti: 1. Vendosjen e "Sekuestros preventive" mbi pasuritë e shtetasve

- A ■■■ D ■■■, e bija e ■■■ dhe ■■■, e datëlindjes ■■ Gusht 19■■, lindur dhe banuese në Pogradec, mbajtëse e pasaportës italiane Nr. ■■■, dhe pasaportën shqiptare Nr. ■■■ e dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale" parashikuar nga neni 287 i K.Penal,
- V ■■■ D ■■■, e bija e ■■■ dhe e ■■■, e datëlindjes ■■ Mars 19■■, lindur dhe banuese në Pogradec, mbajtëse e pasaportës shqiptare Nr. ■■■ si person i lidhur,
- F ■■■ M ■■■ C ■■■, i biri i ■■■, i datëlindjes ■■ Tetor 19■■, shtetas Italian, identifikuar me pasaportën italiane Nr. ■■■ si person i dyshuar për kryerjen e figurës së veprës penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale" parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Baza Ligjore :

Nenet 274-276 të Kodit të Procedurës Penale

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, mbi bazën e informacionit referues të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka regjistruar procedimin penal Nr. 395 datë 22 Tetor 2018, për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" parashikuar nga nenei 287 i K.Penal.

Nga sa rezulton nga informacioni referues, rezulton se policia gjyqësore është vënë në dijeni nga agjensi të tjera ligjzbatuese, në lidhje me veprimtari të dyshimte financiare të shtetases A [redacted] D [redacted], e datëlindjes [redacted] Gusht 19 [redacted], lindur dhe banuese në Lagj. Nr.3 Pogradec.

Nga sa rezulton, kjo shtetase posedon dy llogari bankare në Bankat e Nivelit të Dytë që Operojnë në Republikën e Shqipërisë, konkretisht ne Tirana Bank dhe Raiffeisen Bank, të dyja në Euro, në të cilat janë transferuar shuma të konsiderueshme monetare, nga llogaritë bankare të një kompanie në Panama të quajtur "G [redacted] H [redacted] C [redacted]".

Në lidhje me këto transferta, shtetasja A [redacted] D [redacted] dhe bashkëshorti i saj shtetasi italian F [redacted] C [redacted], i cili vepron si person i autorizuar, kanë deklaruar në përshkrimin e origjinës së shumave se vijnë nga një kompani e bashkëshortit F [redacted] në Itali, e cila ka objekt prodhimin e veshjeve. Këto veshje shiten në Amerikën e Jugut tek shoqëria G [redacted] H [redacted] C [redacted], e cila i dërgon shumat në fjalë në llogarinë personale të shtetases A [redacted] D [redacted] në Shqipëri.

Nga informacioni paraprak, rezultonte se në llogaritë e kësaj shtetaseje, janë transferuar një shumë prej rreth 700.000 (shtatëqind mijë) Euro, një pjesë e të cilave janë përdorur për blerjen e pronave të paluajshme kryesisht në Qytetin e Pogradecit, nga vetë shtetasja A [redacted] D [redacted], nëna e saj V [redacted] D [redacted] si dhe bashkëshorti i saj F [redacted] C [redacted].

Nga verifikimi në adresen e Qendrën Kombëtare të Bizneseve, rezulton se këta shtetas nuk kanë veprimtari tregëtare në Republikën e Shqipërisë.

Pas administrimit të të dhenave bankare, rezulton se në llogarinë bankare në Euro të kësaj shtetaseje në Raiffeisen Bank në periudhën 16 Gusht 2016-18 Qershor 2018 janë transferuar rreth 153.000 (njëqind e pesëdhjetë e tre mijë) Euro, ndërsa në llogarinë bankare të po kësaj shtetaseje ne Tirana Bank, në periudhën kohore Tetor 2017- 20 Qershor 2018 janë transferuar një shumë prej 46.500 (dyzetë e gjashtë mijë e pesëqind) Euro.

Të gjitha transfertat në llogaritë bankare të kësaj shtetaseje, janë nga shtetasi italian F [redacted] C [redacted] si dhe nga Kompania "G [redacted] H [redacted] C [redacted]" e cila sikurse u tha e ka selinë e veprimtarisë në Panama, e cila konsiderohet si "parajse fiskale" nga një sërë organizmash ndërkombëtare.

Nga verifikimet paraprake, rezulton se shtetasja A [REDACTED] D [REDACTED], është proceduar më parë nga Autoritetet Gjyqësore Italiane, nga Guardia di Finanzia e Comos, për veprat penale të mashtrimeve financiare, fallsifikimit, dhe shitjes së produkteve me shenja fallso, parashkuar nga nenet 61, 517, dhe 474 të Kodit Penal të Republikës së Italisë, dhe ndaj saj dhe shtetasit italian F [REDACTED] C [REDACTED] është ndërmarrë një hetim financiar në kuadër të të cilit janë sekuestruar shuma të konsiderueshme monetare. Në lidhje me këtë fakt, nga Interpol Tirana jemi venë në dijeni se Prokuroria e Milanos, ka regjistruar procedimin penal Nr. 2353 të vitit 2018.

Po kështu rezulton se të dy këta shtetasve Guardia di Finanza, Ju ka sekuestruar rreth 2.388.611 (dymilion treqind e tetëdhjetë e tetë mijë gjashtëqind e njëmbëdhjetë) Euro.

Po kështu nga dokumentacioni i administruar rezulton se shtetasit A [REDACTED] D [REDACTED] dhe shtetasi Italian F [REDACTED] C [REDACTED] me kontratat Nr. [REDACTED] Rep. Nr. [REDACTED] Kol. datë 21 Dhjetor 2016 të lidhur para noterit E [REDACTED] B [REDACTED], ka blerë një apartament banimi me sipërfaqe 74.4 m2, ndodhur në Bulevardin Dëshmorët e Pojskes Pogradec, konkretisht pasurinë Nr. [REDACTED] Vol. [REDACTED] Fq. [REDACTED] Z.K.8581, ndërsa me kontratën Nr. [REDACTED] rep. Nr. [REDACTED] Kol. datë 21 Dhjetor 2016 të lidhur para noterit E [REDACTED] B [REDACTED], ka blerë një apartament banimi me sipërfaqe 97.61 m2, ndodhur në Bulevardin Dëshmorët e Pojskës Pogradec, konkretisht pasurinë Nr. [REDACTED] Vol. [REDACTED] Fq. [REDACTED] Z.K.8581.

Vlera e aparatamentit të parë me sipërfaqe 74.4 m2 sipas kontratës është 26.570 (njëzetë e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) euro, ndërsa 97.61 m2 është 34.857 (tridhjetë e katër mijë tetëqind pesëdhjetë e shtatë) Lekë.

Më pas aparatamentin prej 97.61 m2 konkretisht pasurinë Nr. [REDACTED] Vol. [REDACTED] Fq. [REDACTED] Z.K.8581, të dy shtetasit e dyshuar A [REDACTED] D [REDACTED] dhe F [REDACTED] C [REDACTED], me kontratën Nr. [REDACTED] Rep. Nr. [REDACTED] Kol. datë 04 Prill 2018, e lidhur para noterit E [REDACTED] B [REDACTED], ja kanë dhuruar këtë aparatament shtetases V [REDACTED] D [REDACTED] e cila është nëna e A [REDACTED].

Po kështu në emër të shtetases V [REDACTED] D [REDACTED], ekziston dhe një automjet tip Mercedes Benz prodhim i vitit 2008 me targë AA [REDACTED] RL të cilën e ka blerë nga shtetasi R [REDACTED] S [REDACTED] me kontratën Nr. [REDACTED] Rep. Nr. [REDACTED] Kol. datë 06 Qershor 2018, e lidhur para noterit E [REDACTED] B [REDACTED], në vlerën 1 830 000 (një milion e tetëqind e tridhjetë mijë) lekë.

Po kështu me kontratën e sipërmarrjes Nr. [REDACTED] Rep. Nr. [REDACTED] Kol. datë 18 Qershor 2018, e lidhur para Noterit E [REDACTED] B [REDACTED], shtetasja V [REDACTED] D [REDACTED] me cilësinë e porositësit ka porositur tek "Shoqëria A [REDACTED]-N [REDACTED] sh.p.k." 5 (pesë) njësi pasurie të paluajtshme në vlerën totale 693.000 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë) Euro.

Në kontratën në fjalë, përshkruhen dhe pasuritë dhe konkretisht pasuria Nr. [redacted] e llojit apartament 2+1 me sipërfaqe totale (njëqind e tridhjetë e katër pikë një metër katrorë), në katin e katërt, shkalla 5, kuota +16.10.

Pasuria e dytë e porositur me këtë kontratë është apartament me Nr. [redacted] e llojit apartament 2+1 me sipërfaqe totale 127.3 (njëqind e njëzetë e shtatë pikë tre) metra katrorë, në katin e katërt shkalla 5, kuota +16.10.

Pasuria e tretë e porositur me këtë kontratë është apartament me Nr. [redacted] e llojit apartament 1+1 me sipërfaqe totale 75.5 (shtatëdhjetë e pesë pikë pese) metra katrorë, në katin e tretë, Shkalla 4, kuota +12.6;

Pasuria e katërt e porositur me këtë kontratë është apartament me Nr. [redacted] e llojit apartament 1+1 me sipërfaqe totale 75.4 (shtatëdhjetë e pesë pikë katër) metra katrorë, në katin e katërt shkalla 4 kuota +12.6

Pasuria e pestë e porositur me këtë kontratë është njësi shërbimi (biznesi), e ndodhur në katin përdhe (kati 0) me sipërfaqe totale 106.3 (njëqind e gjashtë pikë tre) metra katrorë, duke u saktësuar më skicën përkatëse;

Në lidhje me këto pasuri të sipërcituara, ato do të ndërtohen dhe përfshihen në godinën shumëkatëshe të banimit të ndërtuar (ose në ndërtim e sipër) nga Shoqëria A [redacted]-N [redacted] sh.p.k. sipas lejes së ndërtimit të miratuar me vendimin Nr. [redacted] datë 21 shkurt 2017 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

Sikurse u tha më sipër, vlera e pasurive të blera e të porositura në një interval shumë të shkurtër kohor, arrin në një vlerë të konsiderueshme prej rreth 750.000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) euro.

Ndërkohë rezulton se në llogaritë bankare të shtetases A [redacted] D [redacted] në Tirana Bank dhe Raiifaisen Bank, janë kredituar gjatë këtyre viteve shuma rreth 200.000 (dyqind mijë) Euro, nga të cilat rezulton se një pjesë e konsiderueshme janë kaluar me urdhërues shtetasin F [redacted] C [redacted], si dhe pjesa tjetër nga llogaritë bankare të një kompanie në Panama të quajtur "G [redacted] H [redacted] C [redacted]".

Vet fakti që sipërmarrja është dukshëm me e lartë se shumat e transferuara nga personat e dyshuar nëpërmjet bankave, bën që të lindin dyshime mbi origjinën e shumave të parave, për më tepër që në shtetin Italian ku shtetasit e dyshuar A [redacted] D [redacted] dhe F [redacted] C [redacted] kanë dhe aktivitetin më të madh tregëtar, ka filluar një procesim penal duke u sekuestruar një sasi prej 2.388.611 (dymilion treqind e tetëdhjetë e tetë mijë gjashtëqind e njëmbëdhjetë) Euro.

Dyshimi shtohet dhe nga fakti, që transfertat në llogaritë bankare janë bërë gjithmonë nën vlerën 10.000 (dhjetë mijë) Euro, me qëllim që të mos raportohen në Njësitë e Inteligjencës Financiare të të dy vendeve si në Itali nga e kanë burimin dhe në Shqipëri ku kanë mbërritur, me qëllim final që të mos monitorohen si transfertat.

Po kështu ky dyshim mbështetet dhe në faktin që në Shqipëri, jo vetëm që këta shtetas nuk kanë aktivitete tregëtar, por dhe në faktin që shumica e pasurive pavarësisht se si janë porositur fillimisht, janë regjistruar në emër të shtetases V [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR], 77 vjeçare, e cila nuk ka pasuri të tjera të krijuara dhe as origjinë nga sa rezulton nga të dhenat bankare.

Nga sa më sipër, organi procedues çmon se ekzistojnë dyshime se origjina e shumave të parave të xhiruara në llogaritë bankare të shtetases A [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR], është e dyshimte. Po kështu është e dyshimte origjina e shumave të parave të përdorura për blerjen dhe porositjen e pasurive të paluajtshme, si dhe automjetit të shtetases V [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR]. Ky dyshim shtohet nga fakti se shumica e pasurive në një vlerë të konsiderueshme figurojnë në pronësi, si dhe janë porositur nga shtetasja V [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR]. Duke qenë se kjo shtetase nuk ka llogari bankare, dhe mosha e saj është relativisht e madhe për të kryer aktivitete financiare në këto vlera të konsiderueshme monetare, lind dyshimi se emri i saj është përdorur për të lidhur kontrata fiktive, me qëllim mbulimin e dyshimeve të pastrimit të mundshëm të produkteve të veprës penale nga shtetasja A [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR] dhe F [REDAKTUAR] C [REDAKTUAR].

Neni 274 i K.Pr.Penale, parashikon "Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. Sekuestroja mund të vendoset dhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të K.Penal".

Nga sa më sipër, organi i akuzës, çmon se lindin dyshime për origjinën e shumave të parave që kanë kaluar në llogarinë bankare të shtetases A [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR], duke qenë se lindin dyshime në lidhje me faktin që këto pasuri të paluajtshme, figurojnë si pronësi në emër të shtetases V [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR], apo të porositura me kontrata sipërmarrje prej saj, janë në emër të kësaj të fundit pikërisht për të fshehur dyshimet në lidhje me burimin dhe origjinën e tyre. Në këto rrethana, organi i akuzës, çmon se duhet vendosur masa e sigurimit pasuror sekuestro preventive mbi pasuritë në fjalë, me qëllim për të shmangur zgjatjen e pasojave të veprës penale.

Masa e sigurimit pasuror "Sekuestro preventive" është e përshtatshme në raport me rëndësinë e faktit.

Për këto arsye dhe në bazë të neneve 274-276 të K.Pr.Penale,

K E R K O J

1. Vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme të shtetases A [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR], V [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR] dhe F [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR]

C si për pasuritë e paluajtshme të regjistruara dhe për ato të porositura dhe konkretisht.

- a. Nr. [redacted] Vol [redacted] Fq. [redacted] Z.K.8581, ndodhur në Rr. Dëshmorët e Pojskës Pogradec;
- b. Nr. [redacted] Vol. [redacted]. Fq. [redacted] Z.K.8581, ndodhur në Rr. Dëshmorët e Pojskës Pogradec;
- c. Pasuria Nr. [redacted] e llojit apartament 2+1 me sipërfaqe totale (njëqind e tridhjetë e katër pikë një metër katrorë), në katin e katërt, shkalla 5, kuota +16.10.
- d. Pasuria e dytë e porositur me këtë kontratë është apartament me Nr. [redacted] e llojit apartament 2+1 me sipërfaqe totale 127.3 (njëqind e njëzetë e shtatë pikë tre) metra katrorë, në katin e katërt shkalla 5, kuota +16.10.
- e. Pasuria e tretë e porositur me këtë kontratë është apartament me Nr. [redacted] e llojit apartament 1+1 me sipërfaqe totale 75.5 (shtatëdhjetë e pesë pikë pese) metra katrorë, në katin e tretë, Shkalla 4, kuota +12.6;
- f. Pasuria e katërt e porositur me këtë kontratë është apartament me Nr. [redacted] e llojit apartament 1+1 me sipërfaqe totale 75.4 (shtatëdhjetë e pesë pikë katër) metra katrorë, në katin e katërt shkalla 4 kuota +12.6
- g. Pasuria e pestë e porositur me këtë kontratë është njësi shërbimi (biznesi), e ndodhur në katin përdhe (kati 0) me sipërfaqe totale 106.3 (njëqind e gjashtë pikë tre) metra katrorë, duke u saktësuar më skicën përkatëse;

Në lidhje me këto pasuri të sipërcituara shkronjat "C"- "G" dhe ato do të ndërtohen dhe përfshihen në godinën shumëkatëshe të banimit të ndërtuar (ose në ndërtim e sipër) nga Shoqëria A [redacted] N [redacted] sh.p.k. sipas lejes së ndërtimit të miratuar me vendimin Nr. [redacted] datë 21 shkurt 2017 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

- 2. Me ekzekutimin e këtij vendimi për vendosjen e sekuestros, të ngarkohet OPGj J [redacted] Z [redacted] dhe L [redacted] Q [redacted] pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Z.R.P.P. Pogradec dhe Z.R.P.P. Tiranë.

PROKURORI

S [redacted] K [redacted]

6